

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve (me çmime aktuale dhe konstante), TM2 2023


15.09.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) për tremujorin e dytë (TM2) 2023, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak.

BPV-ja në TM2 2023 shënon rritje reale për 2,02% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak

Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera (5,77%); aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (5,05%); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (3,66%); bujqësia, pyjet dhe peshkimi (2,81%); ndërtimtaria (2,70%); tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (2,38%); aktivitetet e pasurive të paluajtshme (2,15%); informacioni dhe komunikimi (2,02%).

Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



Aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor ishin: administrata publike, sigurimi social, arsimi dhe shëndetësia (-0,76%); industria nxjerrëse, përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit (-2,03%).

Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje ishin: eksporti i shërbimeve (13,62%); importi i mallrave dhe shërbimeve (6,29%); shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (3,96%); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3,68%); formimi i bruto kapitalit (2,04%).

Ndërsa rënie kishte: eksporti i mallrave (-10,67%).

Bruto Produkti Vendor Tremujor (Mijëra EUR)

	2021				2022				2023	
	I	II	III	IV	I*	II*	III*	IV*	I*	II*
BPV-ja Nominale	1 628 514	1 925 614	2 234 040	2 169 708	1 802 665	2 152 014	2 534 757	2 465 433	1 960 466	2 305 111
BPV-ja Reale	1 570 235	1 854 500	2 092 452	1 982 066	1 702 425	1 981 356	2 306 809	2 246 743	1 873 207	2 195 449
Rritja reale e BPV-së %	4,87	16,32	14,08	7,38	4,54	2,89	3,26	3,55	3,91	2,02

Për më shumë informata lidhur me publikimin e Bruto Produktit Vendor (BPV) për tremujorin e dytë (TM2) 2023, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraparak, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Budget>